



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr. 384/9 Prot.

Tiranë, më 30/06/2016

V E N D I M

Nr. 76, Datë 30/06/2016

PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË BASHKINË MIRDITË "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE".

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10,15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, vlerësimit financiar dhe menaxhimin e administrimin e aseteve të qëndrueshme”, të ushtruar në Bashkinë Mirditë, për periudhën nga data 01.07.2014 deri 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të Bashkisë Mirditë për vitin 2014 dhe 2015, u konstatua se shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe paaftësisë zënë peshën kryesore në shpenzimet e buxhetit në masën 43 %, çka tregon mungesën e politikave sociale për punësimin në këtë njësi vendore.

Kështu për vitin 2015 janë trajtuar 1.890 familje me ndihmë ekonomike dhe 1.699 persona me paaftësi të kufizuar.

Rekomandimi: Bashkia Mirditë të planifikojë saktë buxhetin, duke ulur shpenzimet e ndihmës ekonomike të cilat janë në nivele të larta, nëpërmjet përmirësimit të politikave sociale për nxitjen e punësimit, si dhe të sigurojë një raport të drejtë midis shpenzimeve të buxhetit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Mirditë nuk ka ngritur dhe miratuar një sistem të përshtatshëm dhe efektiv të **menaxhimit financiar dhe të kontrollit** në zbatim të nenit 8, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", për periudhën 2015-2016.

-Nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) si dhe nuk janë realizuar takime në lidhje me mangësitë që shqetësojnë njësinë në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

- Nuk ka një kuptim të qartë të menaxhimit të riskut, nuk ka strategji të riskut apo identifikim të tij sipas nenit 21 të ligjit.

-Nuk është formuluar deklaratat e vizionit dhe misionit të njësisë në të cilën përcaktohen objektivat strategjike afatgjatë për Bashkinë Mirditë në zbatim të kërkesave të VKM-së nr.691, datë 29.7.2015 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020".

Rekomandimi: Bashkia Mirditë të marrë masa për implementimin e plotë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në bashkinë Mirditë u konstatuan **fatura të pa likuiduara** deri më datë 31.12.2015, në vlerën **43 milion lekë**, nga këto: 19 milion lekë ish-bashkia Rrëshen, 24 milion lekë ish-bashkia Rubik, ish-komunat sot Njësi Administrative Kaçinar, Selitë, Kthellë, që do të rëndojnë në fondet e Bashkisë në vazhdim të vitit 2016.

Rekomandimi: Bashkia Mirditë të marrë masa për reduktimin e shpenzimeve, të rrisë të ardhurat vendore, të vjelë debitorët dhe të shikojë çdo mundësi tjetër me miratim të Këshillit Bashkiak, për shlyerjen e faturave të prapambetura në vlerën 43 milion lekë për vitin 2016.

Brenda vitit 2016

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të **taksave dhe tarifave vendore** të bashkisë Mirditë, për vitin 2014 dhe 2015, u konstatua se:

-Taksa e tregut paraqet 1,472 mijë lekë mungesë të ardhurash përkatësisht: 372 mijë lekë për vitin 2014 dhe 1,100 mijë lekë për vitin 2015, diferencë kontraktore e taksës së tregut, sipas listave pranë zyrës taksave vendore bashkia Mirditë.

-Taksa e pastrimit familjar për vitin 2015 është planifikuar me rezerva për vlerën 1,220 mijë lekë, pasi është planifikuar 500 mijë lekë nga 1,720 mijë lekë që duhej .

-Debitorët e taksave vendore deri më datë 01.12.2015, paraqiten për vlerën 831 mijë lekë për 22 subjekte fizike, sipas pasqyrës të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për taksat vendore”, UMF dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore për arkëtimin e **22 subjekteve** debitor me vlerë **831,000 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3-E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nxjerrë njoftim vlerësimit tatimore, të dërgojë bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor për vendosjen e barrës siguruese për mjetet. -Drejtoria e Taksave Vendore të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të marrë masa për arkëtimin e taksave e tarifave, sipas të dhënave që disponon zyra e taksave Mirditë dhe Gjendjes Civile, duke dërguar njoftim vlerësimit abonentëve familjarë me anë të Zyrës Postare.

Brenda vitit 2016

5. Gjetje nga auditimi: U konstatua se disa automjete të ish-komunave të Bashkisë Mirditë qëndrojnë në ambiente private, pra nuk disponohen fizikisht në njësitë administrative Fan, Kthellë, Selitë, Orosh.

Rekomandimi: Bashkia Mirditë të marrë masa për administrimin e automjeteve të ish-komunave Fan, Kthellë, Selitë dhe Orosh duke i zhvendosur ato nga ambientet private pranë Bashkisë ose qendrave administrative të saj.

Brenda muajit Korrik 2016

6. Gjetje nga Auditimi: Ish-Bashkia Rrëshen dhe ish-Komunat Kthellë Fan, Orosh, për vitet 2014-2015, nuk kanë ngritur Zyrën e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe plotësimin e saj me specialistë të fushës, por ka funksionuar vetëm me një specialist për bujqësinë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 121 datë 17.2.2011, kreu IV “Detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në Komuna dhe/ose Bashki”, pika”1”.

Rekomandim: Bashkia Mirditë të marrë masa për të ngritur Zyrën e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës(ZMMT) dhe plotësimin e saj me specialistë të fushës.

Në vijimësi

7. Gjetje nga Auditimi: U konstatua se në ish-Bashkinë Rrëshen janë evidentuar mospërputhje të regjistrimit fillestar në ZVRPP, për tokat arë të dhëna me AMTP, si dhe mangësi në plan rielivimet e ngastrave të tokave, në kundërshtim me ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 të ndryshuar dhe nenet 25 e 45, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Rekomandim: Bashkia Mirditë të marrë masa për njoftimin e fermerëve, për plotësimin e dokumentacionit për sipërfaqet e përfshira në AMTP, shoqëruar me plan rielivimet e ngastrave hartuara nga ZMMT e Bashkisë, për regjistrim në ZVRPP Rrëshen, në zbatim të VKM nr. 994 datë 9.12.2015”Për regjistrimin e Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi”.

Brenda vitit 2016

8. Gjetje nga Auditimi: U konstatua se ish-Bashkia Rrëshen disponon 788 hektarë tokë arë të pandarë, ish-Bashkia Rubik 303 hektarë nga fondi i tokës arë të ish-NB Rrëshen dhe ish-Kooperativave Bujqësore, për të cilat nuk janë zbatuar procedurat për ndarjen e tyre, në kundërshtim me VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" pika 3 dhe VKM nr. 121 datë 17.2.2011, kreu IV "Detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në komuna dhe/ose bashki", pika "e", për të cilat mungon programi i punës nga Bashkia për trajtimin e kësaj prone.

Rekomandimi: Bashkia Mirditë të marrë masat për trajtimin e tokës arë të pandarë, në Njësinë Administrative Rrëshen për sipërfaqen 788 ha, Njësinë Administrative Rubik për sipërfaqen 303 hektarë, me program pune nga ekspertë të fushës, me komision për ndarjen ose dhënien me qira, të shoqëruar me hartat përkatëse sipas akteve nën ligjore.

Brenda vitit 2016

9. Gjetje nga Auditimi: Ish-Bashkitë Rrëshen dhe Rubik, ish-Komunat Fan, Orosh, Kthellë në miratimet e strukturave organike të administratës për vitet 2014 dhe 2015, nuk kanë parashikuar strukturë të veçantë për administrimin, inventarizimin, gjendjen faktike të aseteve dhe mbledhjen e të ardhurave nga kontratat e qirave, në kundërshtim me pikën 9 të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 "*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore*".

Rekomandim: Bashkia Mirditë të marrë masa për ngritjen e strukturës për administrimin dhe inventarizimin e aseteve dhe pronave të gjithë Njësiave Administrative (ish-Bashkisë Rrëshen dhe Rubik si dhe ish-Komunave) në zbatim të reformës vendore në koordinim me strukturat e tjera të Bashkisë.

Brenda vitit 2016

10. Gjetje nga Auditimi: U konstatua se, në ish-Bashkitë Rrëshen e Rubik dhe ish-Komunat Kthellë Fan, Orosh për vitet 2014-2015, nuk ka evidenca të dorëzimit të dokumentacionit pranë ZVRPP Mirditë, për regjistrimin e sipërfaqes pyjore, në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 "*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore*", ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore*" Kreu VI-të, neni 32, dhe ligjin nr. 33/2012, "*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*".

Rekomandim: Bashkia Mirditë të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për inventarizimin e pasurive të llojit pyll dhe kullotë, në gjithë Njësitë Administrative shoqëruar me hartat përkatëse dhe regjistrimin e tyre pranë ZVRPP Mirditë.

Brenda vitit 2016

11. Gjetje nga Auditimi: U konstatua se ish-Bashkitë Rrëshen, Rubik dhe ish-Komunat Kthellë Fan, Orosh, nuk kanë program për regjistrimin e vlerave të pronave në kontabilitet, për pasuritë e llojit pyll dhe kullotë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrit të Financave "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" kap. IV, pikës 22 të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 "*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore*".

Rekomandim: Bashkia Mirditë, të marrë masa krahas inventarizimit të pasurive, të pyjeve kullotave dhe objekteve të tjera, të ngrejë komision me ekspertë për vlerësimin e pasurive dhe regjistrimin e tyre në kontabilitet sipas akteve ligjore.

Brenda vitit 2016

12. Gjetje nga auditimi: Për menaxhimin e pasurive pyje e kullota, nga ish-Bashkitë Rrëshen e Rubik, nuk është përpiluar dhe miratuar plan i ri i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, në kundërshtim me nenin 5, pika 5 të ligjit nr. 9585, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar. Nuk ka evidenca për bashkëpunimin me Ministrinë e Mjedisit dhe shoqatat e pyjeve dhe atyre mjedisore, në kundërshtim me kërkesat e pikës 5/dh të VKM nr. 396, datë 21.6.2006 “Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore”.

Rekomandim: Bashkia Mirditë, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Pyjor Lezhë, të hartojë planin e mbarështimit dhe ruajtjes së sipërfaqeve pyjore dhe kullotave në gjithë njësitë administrative të saj.

Brenda vitit 2016

13. Gjetje nga auditimi: Ish-Bashkitë Rrëshen, Rubik dhe ish-Komunat Kthellë, Fan, Orosh, Kacinar, Selitë, për vitet 2014-2015, kanë mangësi në inventarizimin e dosjeve të tenderave dhe arkivimin e tyre, në kundërshtim me udhëzimet e APP-së, nenin 30 të Modelit nr. 8 “Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Rekomandim: Bashkia Mirditë të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të prokurimit për tenderat e realizuara në periudhën 2014-2015.

Brenda vitit 2016

14. Gjetje nga auditimi: Dosjet teknike të investimeve të cilat u audituan rezultuan me mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

Rekomandim: Bashkia Mirditë, nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Territorit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

Brenda vitit 2016

15. Gjetje nga auditimi: Në ish-Bashkinë Rubik u konstatua se komisioni i vlerësimit në proces verbalin e datës 01/02/2010 “për djegien nga zjarri të 1 banese” në fshatin Vau Shkjezë, padrejtësisht ka përfshirë dhe vlerësuar me çmime të larta disa pajisje dhe artikuj të pajustificuara, çka ka rritur artificialisht dëmin e vlerësuar për vlerën **836,518 lekë**.

Rekomandimi: Bashkia Mirditë të zbresë shumën **836,518 lekë** nga vlera e miratuar 2,229,219 lekë sipas vendimit të Këshillit Bashkisë Rubik nr. 5, datë 5.02.2010, për djegien nga zjarri të 1 banese, pasi ish-komisioni i vlerësimit padrejtësisht ka përfshirë dhe vlerësuar me çmime të larta disa artikuj dhe pajisje të pajustificuara, çka ka rritur artificialisht dëmin e vlerësuar.

16. Gjetje nga auditimi: U konstatua se nga **ish-Bashkia Rrëshen** sot bashkia Mirditë nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH për vlerën **11,394,513 lekë**, konkretisht:

a. vlera 450,000 lekë, sipas shkresës nr. 1188/72, datë 27.3.2015 të KLSH, nga Subjekti juridik “” shpk 5,600 lekë, Përgjegjësi i Urbanistikës A.M. 5,160 lekë, N/kryetari i bashkisë J.P. 218,121 lekë, N/kryetar i bashkisë M.P. 221,121 lekë. Ndërkohë Subjekti juridik “” shpk nuk ka likuiduar vlerën 3,163,258 lekë, pasi e ka fituar me vendimin i Gjykatës shkallës parë Shkodër nr. 954, datë 09.12.2015 dhe Bashkia Mirditë padrejtësisht nuk e ka apeluar këtë vendim.

b. vlera 10,944,513 lekë, sipas shkresës nr.150/9, datë 30.6.2012 të KLSH, nga Subjekti “” shpk 9,362,055 lekë, për taksë ndikimit të infrastrukturës të papaguar në objektin “Godinë banimi 8 kat + 2 kat shërbime + 1 kat parkim nentoke”, Subjekti “” shpk 679,979 lekë, për diferencë taksë ndikimit të infrastrukturës të llogaritur më pak dhe të papaguar në objektin “Godinë shërbime 2 kat + 7 kat banim + 1 kat parkim nentoke”, Subjekti “.” shpk 739,000 lekë, për përfitim tepër në vlerën e paisjeve bashkë tvsh duke rritur artificialisht fondin limit, sipas urdhër shpenzimit nr. 62, datë 11.4.2011, punonjësit e bashkisë Mirditë 138,940 lekë, përkatësisht: V.GJ. 46,313 lekë, L.M. 46,313 lekë dhe T.P. 46,313 lekë, shpenzime të pajustificuara, sipas urdhërshpenzimeve nr. 247, datë 25.10.2010 dhe nr. 274, datë 13.12. 2010, M.N. 19,638 lekë për shpërblim të paligjshëm dhe GJ.D. 4,900 lekë shpenzim i pajustificuar në 2010.

Rekomandimi: Bashkia Mirditë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **11,394,513 lekë**, rekomandime të pa zbatuara plotësisht nga 2 auditimet e KLSH, sipas shkresave nr. 1188/72, datë 27.3.2015 dhe nr.150/9, datë 30.6.2012.

-Drejtoria e Taksave Vendore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën 9,362,055 lekë ndaj subjektit “” shpk dhe subjektit “” shpk 679,979 lekë, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, të nxjerrë njoftimin për vlerësimet tatimore, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

-T’i dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimi të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920 ”Për procedurat tatimore datë 19.05.2008, i ndryshuar.

-T’i kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, vendosja e barrës siguroese (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar.

Brenda vitit 2016

17. Gjetje nga auditimi: U konstatua se Komuna Fan nuk ka kontabilizuar dhe nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna më parë nga KLSH për vlerën **352,424 lekë**, sipas raportit përfundimtar të auditimit të ushtruar në muajin shkurt 2015.

Rekomandimi: Bashkia Mirditë të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **352,424 lekë**, rekomandime të pa zbatuara nga auditimi i fundit i KLSH, për ish-Komunën Fan, respektivisht: GJ.K. 23,866 lekë, N.M. 31,693 lekë, S.D. 31,693 lekë, GJ.P. 71,533 lekë, GJ.GJ. 25,826 lekë, T.N. 8,333 lekë, N.T. 17,493 lekë, N.M. 17,493 lekë, Z. B. 17,493 lekë dhe vlera 107,000 lekë sipas urdhër shpenzimit nr. 246, date 14.12.2012.

Brenda vitit 2016

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 608-628 e në vijim të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 9-14 dhe 21-33 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Kap IV, pika 93 e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik nga ana e kryetarit të Bashkisë Mirditë të nxirren aktet administrative përkatëse (Vendimet ekzekutive) dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe (Nëpunësi zbatues), të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 30,666,402 lekë**, nga kjo:

- a. vlera 18,916,702 lekë dëm ekonomik, në fushën financiare, prokurimet publike dhe zbatimin e kontratave etj.
- b. vlera 11,749,700 lekë, e ardhur e munguar e tarifës ligjore të hidrocentralit mbi lumin Fan i vogël nga subjekti “██████████”.

Në mënyrë të detajuar paraqiten më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: U konstatua se subjekti “██████████” sh.a nuk ka paguar:

- vlerën **11,749,700 lekë**, e ardhur e munguar **në dëm të buxhetit** të Bashkisë Mirditë, tarifë për heqjen nga fondi pyjor kullësor i sipërfaqes që do të përdoret për ndërtimin e hidrocentralit mbi lumin Fan i vogël, sipas studimit tekniko ekonomik datë 23.4.2014 të bashkisë, bazuar në ligjin nr. 39/2015 datë 16.4.2015 “Për heqjen nga fondi pyjor kullësor kombëtar të sipërfaqes dhe zvogëlimin në vëllim të fondit pyjor kombëtar në ngastrat e ekonomive pyjore të cilat preken nga ndërtimi i hidrocentraleve” neni 2, pika”c”, lidhja 1,faqe 2 dhe 3,

- taksën e sipërfaqes së ndërtimit të veprës së hidrocentralit (diga, tunelet) dhe nuk ka dhënë asnjë dokument mbi sipërfaqen e taksueshme, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.6.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 21, pika 2 dhe 3 si dhe anekset 1,2 dhe 2.1 që janë pjesë përbërëse e këtij ligji. Për rrjedhojë nuk mund të llogaritet taksa për sipërfaqen e ndërtimit, pasi mungon dokumentacioni i sipërfaqes së ndërtimit të veprës së hidrocentralit.

-Taksa e ndikimit në Infrastrukturë e paguar nga “██████████” në vlerën 8.6 milion lekë është më e vogël se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës, ku infrastruktura rezulton e dëmtuar dhe e pa llogaritur në preventivat e investimit (rrugë, landfill-e), në kundërshtim me nenin 27, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.6.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

-Tarifa për zënien e hapësirës publike nuk është dhënë asnjë informacion Bashkisë Mirditë për sipërfaqet, hapësirën publike të zëna me objekte të ndryshme në funksion të kësaj shoqërie, në kundërshtim me neni 16, pika”c” të ligjit nr. 9632 datë 30.6.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Rekomandimi: Bashkia Mirditë të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin nga subjekti “██████████” të vlerave, sa vijon:

-vlerën 11,749,700 lekë, e ardhur e munguar në dëm të buxhetit të Bashkisë Mirditë, tarifë për heqjen nga fondi pyjor kullësor i sipërfaqes që do të përdoret për ndërtimin e hidrocentralit mbi lumin Fan i vogël.

- Bashkia Mirditë të marrë dokumentet për sipërfaqen e taksueshme të veprës së hidrocentralit (diga, tunelet etj) dhe mbi bazën e saj të bëjë përllogaritjen e nevojshme duke kërkuar arkëtimin e taksës të sipërfaqes së shfrytëzuar për ndërtimin e veprës.
- Bashkia Mirditë të bashkëpunojë me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Mjedisit për përcaktimin e saktë të vlerës 0,1 % të investimit për vlerën e dëmtuar të infrastrukturës rrugore.
- Bashkia Mirditë të marrë masa për llogaritjen dhe vjeljen e tarifës zënies hapësirës publike nga ndërtimi i hidrocentralit.

Brenda muajit Shtator 2016

2. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion Shkolla 9-vjeçare Kaçinar”, ish-Komuna Kaçinar, Mirditë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume **punë të pakryera** në vlerën **5,074,882 lekë dëm ekonomik** pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Kaçinar, Mirditë dhe OE mbikëqyrës të punimeve “██████████” sh.p.k, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

Rekomandim: Bashkia Mirditë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **5,074,882 lekë** pa t.v.sh nga OE “██████████” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit, sipas kontratës nr. 203 prot., datë 01.09.2015 me objekt “Rikonstruksion Shkolla 9-vjeçare Kaçinar” me ish-Komunën Kaçinar, Mirditë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda vitit 2016

3. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim Ujësjiellësi për Fshatrat Arrëz, Kaçinar, Simon”, ish-Komuna Kaçinar, Mirditë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në vlerën **7,233,509 lekë dëm ekonomik** pa t.v.sh, nga të cilat: vlera 6,741,339 lekë pa tvsh për punime të pakryera dhe vlera 492,170 lekë pa tvsh, si rrjedhojë e ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës. Veprime në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me AK ish-Komuna Kaçinar dhe OE mbikëqyrës të punimeve “██████████” sh.p.k, neni 4 dhe neni 6 pika 1.

Rekomandim: Bashkia Mirditë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **7,233,509 lekë** pa t.v.sh nga OE “██████████” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 3840

prot., datë 11.06.2015 me objekt “Ndërtim Ujësjellësi për Fshatrat Arrëz, Kaçinar, Simon”, ish Komuna Kaçinar, Mirditë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda vitit 2016

4. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim sistem ngrohje shkolla 9 vjecare në qytetin Rubik, ish-Bashkia Rubik, viti 2104” rezultoi se: KVO në vlerësimin përfundimtar të ofertave, datë 8.9.2014, ka vepruar me dy standarte, pasi të dy operatorët kanë pasur mangësi në plotësimin e kriterëve të vendosura në DST, duke shkaktuar një **dëm ekonomik** për vlerën **1,406,247 lekë**, nga kualifikimi i padrejtë dhe shpallja fitues e operatorit “██████████” shpk me vlerë më të lartë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Mirditë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,406,247 lekë**, nga **KVO** e ish-Bashkisë Rubik, M.P. 351,561 lekë, G.M. 351,561 lekë, F.P. 351,561 lekë dhe Gj.V. 351,561 lekë ish-titullar i AK, për kualifikim të padrejtë dhe shpalljen fitues të operatorit “██████████” me vlerë më të lartë, në objektin “Ndërtim sistem ngrohje shkolla 9 vjecare në qytetin Rubik viti 2014”.

Brenda vitit 2016

5. Gjetje nga auditimi: Në ish-Bashkinë Rubik u konstatua sipas urdhër shpenzimit nr. 266, datë 18.12.2014 është likuiduar “██████████” për “sistem i ngrohjes shkolla 9-vjecare Rubik 2014”, rezulton se:

- **vlera 347,400 lekë dëm ekonomik** (1,737,000 x20%) pasi në preventiv dhe situacionin përfundimtar zërat “Makineri dhe Pajisje për sistemin ngrohës shkolla 9-vjecare Rubik” subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në papajtueshmëri me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë është përfituar padrejtësisht nga subjekti juridik “██████████” dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Rekomandim: Bashkia Mirditë të kërkojë në rrugë ligjore subjektin “██████████” arkëtimin e vlerës **347,400 lekë**, për përfitim tvsh, pasi në preventiv dhe situacionin përfundimtar zërat “Makineri dhe Pajisje për sistemin ngrohës shkolla 9-vjecare Rubik” subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh.

Brenda muajit Shtator 2016

6. Gjetje nga auditimi: Në preventivin dhe situacionin përfundimtar të objektit “Riveshja e rrugës Shën Vincenzo De Paoli & rruga At Gjergj Fishta” Bashkia Rrëshen është përfshirë padrejtësisht zëri “fondi rezervë 3 %” për vlerën **359,852 lekë** pa tvsh **dëm ekonomik**, për subjektin “██████████” shpk, pasi fondi rezervë nuk është i zbërthyer në zëra analitikë sipas volumeve dhe çmimeve përkatëse, por është pasqyruar vetëm në vlerë, çka e bën të pa argumentuar dhe të pa justifikuar këtë shpenzim. Përdorimi i fondit rezervë nuk është miratuar nga investitori në asnjë dokument, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” si dhe me kontratën e mbikëqyresit punimeve.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **359,852 lekë** nga subjekti “██████████” shpk, pasi fondi rezervë 3 % nuk është miratuar nga investitori, nuk është i zbërthyer në zëra analitikë sipas volumeve e çmimeve përkatëse, por është pasqyruar vetëm në vlerë, çka e bën të pa justifikuar këtë shpenzim.

Brenda muajit Shtator 2016

7. Gjetje nga auditimi: Në objektin e prokurimit “Rikonstruksion i rrugës Ura e pazarit-Varrezat publike, Unaza e madhe Bashkia Rrëshen” viti 2014, u konstatua se është preventivuar zëri “gërmime shtrese rrugore dhe transport me makineri” në vend të zërit “Gërmim shkëmbi i coptuar me ekskavator 1.0 m³, shkëmb, në themele gjerësi >2 m, me shkarkim në mjet” duke rritur artificialisht fondin limit për vlerën **336,138 lekë dëm ekonomik**, në kundërshtim me manualin teknik të çmimeve të VKM nr. 568 datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Trajtuar në faqet 28-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: Bashkia Mirditë të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **336,138 lekë** nga preventivuesi “██████████”, për rritjen artificiale të fondit limit nga vendosja e zërit “gërmime shtrese rrugore dhe transport me makineri”, në vend të zërit “Gërmim shkëmbi i coptuar me ekskavator 1.0 m³, shkëmb, në themele gjerësi >2 m, me shkarkim në mjet”, në preventivin e procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i rrugës Ura e pazarit-Varrezat publike, Unaza e madhe Bashkia Rrëshen” viti 2014.

Brenda muajit Shtator 2016

8. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksioni i 15 Shtëpive të Komunitetit Rom dhe Egjiptian Rrëshen”, Bashkia Mirditë, me vlerë kontrate 5,177,598 lekë me tvsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan **diferenca çmimi** për vlerën **216,569 lekë dëm ekonomik**, në zërin “çati vendi e zakonshme HD-8m, mbuluar me tjegulla vendi”, pasi padrejtësisht janë vendosur tjegulla marsejeze me çmimin 3,099 lekë/m², në vend të tjegulla vendi me çmim 3,707 lekë/m² sipas preventivit. Veprime në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” pika 3.2 dhe 3.3.

Rekomandim: Bashkia Mirditë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **216,569 lekë** nga OE “██████████” shpk, si sipërmarrës në kontratën nr. 5605 prot., datë 10.11.2015 me objekt “Rikonstruksioni i 15 Shtëpive të Komunitetit Rom Rrëshen”, si rrjedhojë e situacionit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda muajit Shtator 2016

9. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Mirditë dhe ish-komunat e saj u konstatuan dieta të tepërta për vlerën **1,079,000 lekë dëm ekonomik**, për periudhën viti 2014 deri në korrik 2015, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, konkretisht:

- Në ish-komunën Fan, për vlerën 575,000 lekë, sipas urdhër shpenzimeve nr. 161, datë 3.11.2014, nr. 12, datë 3.2.2015, nr. 32, datë 4.3.2015, nr. 53, datë 01.4.2015, nr. 75, datë 5.5.2015, nr. 94, datë 2.6.2015 dhe nr. 117, datë 2.7.2015.

- Në ish-komunën Kaçinar, për vlerën 344,000 lekë, sipas urdhër shpenzimeve nr. 1, datë 9.01.2014, nr. 20, datë 3.04.2014, nr. 40, datë 3.07.2014, nr. 51, datë 4.08.2014, nr. 103, datë 3.12.2014, nr. 25, datë 02.04.2015 dhe nr. 38, datë 05.05.2015.

- Në ish-komunën Selitë, për vlerën 160,000 lekë.

Rekomandimi: Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën **1,079,000 lekë dëm ekonomik**, dieta të tepërta, të përfituara nga disa punonjës të ish-komunave Fan, Kaçinar dhe Selitë, për periudhën viti 2014 deri në korrik 2015.

Brenda muajit Shtator 2016

10. Gjetje nga auditimi: U konstatua se: 24 Këshilltarë në ish-Bashkinë Rrëshen dhe 11 Këshilltarë në ish-Bashkinë Rubik, kanë përfituar pagesa të paligjshme për vlerën **726,702 lekë dëm ekonomik**, pasi nuk kanë marrë pjesë në disa mbledhje këshilli nga data 01.07.2014 deri më datë 31.12.2015, sipas protokollit të mbledhjeve të Këshillit Bashkisë dhe borderove përkatëse, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” kreu VI, neni 29, pika 2 si dhe me nenin nr. 31, pika 2 dhe 8.

Rekomandimi: Bashkia Mirditë të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **726,702 lekë**, për pagesa të paligjshme të disa Këshilltarëve të ish- Bashkisë Rrëshen e Rubik, pasi nuk kanë marrë pjesë në disa mbledhje të këshillit bashkiak, për periudhën 01.07.2014 deri 31.12.2015.

Brenda muajit Shtator 2016

11. Gjetje nga auditimi: Në ish-komunën Kaçinar për periudhën korrik 2014-korrik 2015, nga ish-kryetari i komunës është përfituar bonus transporti në vlerën **180,000 lekë dëm ekonomik**, në kundërshtim me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civil” i ndryshuar.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **180,000 lekë** nga ish-kryetari i komunës Kaçinar P.D, për përfitim të paligjshëm të bonusit të transportit në masën 15,000 lekë/muaj, për periudhën korrik 2014-korrik 2015.

Brenda muajit Shtator 2016

12. Gjetje nga auditimi: U konstatua përfitim tepër i shpenzimeve celulare në 3 raste për vlerën **111,000 lekë** në Bashkinë Mirditë dhe ish-komuna Fan, pasi kanë përfituar 10,000 lekë në muaj nga 4,000 lekë në muaj, në kundërshtim me pikën 9, të VKM nr. 864 datë 23.07.2010 “Për pajisjen me telefoni celular të personave juridik e publik“, për periudhën korrik 2014 deri dhjetor 2015, sipas urdhër shpenzimeve përkatëse.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **111,000 lekë** për shpenzime celulare të përfituara tepër, përkatësisht nga: N.G. 72,000 lekë, N.D. 30,000 lekë dhe Gj.P. 9,000 lekë.

Brenda muajit Shtator 2016

13. Gjetje nga auditimi: Në preventivin në objektin “Rikonstruksion i 15 shtëpive të Komunitetit Romëve dhe Egjiptianeve, Bashkia Mirditë” u konstatua se: në

mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 ,“Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, për 3 paisjet: FVË callaturka, FV Lavaman importi dhe FV Bolier, preventivuesi nuk ka ndarë veças vlerën e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlerën e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë vlera **72,000 lekë tvsh** (364,000 x 20 %) është përfituar padrejtësisht nga subjekti “██████” shpk.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **72,000 lekë tvsh** nga subjekti “██████” shpk, pasi në preventiv dhe situacion të objektit “Rikonstruksion i 15 shtëpive të Komunitetit Romëve dhe Egjiptianeve, Bashkia Mirditë” vlera e 3 pajisjeve është llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, nuk është ndarë veças vlera e pajisjes pa tvsh dhe veças vlera e pajisjes me tvsh.

Brenda muajit Shtator 2016

14. Gjetje nga auditimi: U konstatua se subjekti ██████ nuk ka shlyer për vitin 2015 detyrimin kontraktor për qiranë e sipërfaqes pyjore 500 m2, pronë e ish-Bashkisë Rrëshen në ekonominë pyjore Ulëz, parcela 25 për vlerën **323,800 lekë dëm ekonomik**.

Rekomandim: Bashkia Mirditë të marrë masa për arkëtimin e qirasë së papaguar për vitin 2015 nga subjekti ██████ sha, në vlerën **323,800 lekë**, për sipërfaqen pyjore 500 m2, pronë e Bashkisë Mirditë në ekonominë pyjore Ulëz, parcela 25, sipas kontratës nr. 372, datë 10.2.2010.

Brenda muajit Shtator 2016

15. Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Fan, u konstatua një **dëm ekonomik** në vlerën **510,980 lekë**, nga aplikimi gabim i vlerës qirasë, për sipërfaqen e fondit pyjor kulloror dhënë me qira subjektit “██████k”, për vitin 2015, me objekt përdorimi “vendosje tubacioni për furnizimin me ujë të Hidrocentraleve”Shëngjon 1,2,3”, me gjatësi 2.377 kilometra”, në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 ‘Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" Lidhja nr. 2.

Rekomandim: Bashkia Mirditë të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **510,980 lekë** nga subjekti “██████” për aplikimin gabim të vlerës së qirasë, në sipërfaqen e marrë me qira nga fondit pyjor kulloror pronë e Bashkisë Mirditë, në objektin “vendosje tubacioni për furnizimin me ujë të Hidrocentraleve ”Shëngjon 1,2,3”, me gjatësi 2.377 kilometra” viti 2015.

Brenda muajit Shtator 2016

16. Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Orosh, u konstatua një **dëm ekonomik** në vlerën **272,400 lekë**, detyrim kontraktor i papaguar për 8 persona për vitet 2014 dhe 2015 për dhënien me qira të pronave të ish-komunës për ambiente banimi në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” dhe nenet 420 dhe 693 të ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil”.

Rekomandim: Bashkia Mirditë të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e detyrimeve për qiratë e papaguara për vitet 2014, 2015 për vlerën **272,400 lekë**, sipas listave emërore.

Brenda muajit Shtator 2016

17. Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Orosh, u konstatua një **dëm ekonomik** në vlerën **313,800 lekë, konkretisht:**

-vlera 226,800 lekë, detyrim kontraktor për vitin 2015, nga dhënia me qira e fondit pyjor, për sipërfaqen 300 m² subjektit [REDACTED], vendi Nënshejt.

-vlera 87,000 lekë, llogaritje gabim e tarifës fondit pyjor, për sipërfaqen 300 m², sipas kontratës nr. 566, datë 9.2.2011 me subjektin [REDACTED], vendi Shpal, veprime në kundërshtim me lidhjen nr. 2, pika 7 të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, dhe me nenet 420, 693 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil”.

Rekomandim: Bashkia Mirditë të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **313,800 lekë**, nga subjekti [REDACTED] për qira të vitit 2015 për 226,800 lekë, nga subjekti [REDACTED] për llogaritje gabim të tarifës qirasë për 87,000 lekë.

Brenda muajit Shtator 2016

C. MASA ADMINISTRATIVE:

C.1. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Mirditë.

Nga Bashkia Mirditë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, **t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vendosë masë administrative me gjobë**, për 2 kolaudatorët si më poshtë:

1. V.D, nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

Nga mos kontrolli i punimeve në objektin: “Rikonstruksion Shkolla 9-vjeçare Kaçinar” ish-komuna Kaçinar, Mirditë, ka situacionuar dhe kolauduar punime të pakryera me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore në vlerën **5,074,882 lekë** pa tvsh. Veprime këto në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

2. ing. M.P, në cilësinë e kolaudatorit punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- në objektin “Ndërtim Ujësjiellësi për Fshatrat Arrëz, Kaçinar, Simon”, ish-Komuna Kaçinar, Mirditë, nga mos kontrolli, ka situacionuar dhe kolauduar punime të pakryera me pasojë dëm ekonomik në vlerën **7,233,509 lekë**, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

C.2. Për Ministrinë e Zhvillimit Urban (Komisioni i Licencave)

Mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “ Për Licencimin Profesional të individëve dhe

subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit” dhe në nenin 13, nenin 25 dhe pika 1/a, 1/e, e nenit 41, Kreu VI-të, “Sanksione dhe Dispozita kalimtare”, të “Rregullores për Kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit”, për shkelje të ligjshmërisë në zbatimin e punimeve, në fushën e ndërtimit, **i rekomandojmë Komisionit të Licencave**, pranë Ministrisë Zhvillim Urban, **heqjen e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim** (heqjen e Licencës profesionale), për një afat **2 vjeçar**, si më poshtë:

1. K.S. (në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës mbikëqyrës “” Shpk, **për shkeljet e konstatuara** duke raportuar dhe likuiduar punime të pakryera në shumën **12,308,391 lekë**, si më poshtë:

a. Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt: “*Ndërtim Ujësjiellësi për Fshatrat Arrëz, Kaçinar, Simon*” me zbatues punimesh sipërmarrësin “” shpk , ish-komuna Kaçinar, Mirditë, me pasojë **dëm ekonomik** ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën **7,233,509 lekë** pa tvsh, nga të cilat: vlera 6,741,339 pa tvsh për punime të pakryera dhe vlera 492,170 lekë pa tvsh si rrjedhojë e ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës, veprime këto në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, me Kreun II, Pika 3 e Udhëzimit të KM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe me kontratën e sipërmarrjes së punimeve, neni 23, pika 23.2 në kontratën për punë publike nr. 202 prot., datë 07.09.2012.

b. Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt: “Rikonstruksion Shkolla 9-vjeçare Kaçinar”, ish-Komuna Kaçinar, Mirditë, vlera **5,074,882 lekë** pa tvsh si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Kjo vlerë ka ardhur si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera por të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave veprime në kundërshtim me nenin 23/2 të kontratës e sipërmarrjes së punimeve nr. 203 prot., datë 01.09.2015.

Në të 2 objektet e mësipërme u konstatuan se në Dosjen teknike të zbatimit të punimeve mungonte edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- Certifikatat e cilësisë së materialeve: tuba PE, tuba çeliku, çakull, hekur, betoni, rërë, çimento, zhavorr, letër katrama, rrjetë gabion të përdorura në objekt.;
- Provat e cilësisë së betonit të përdorur dhe llaçit, për realizimin e tyre konform projektit të zbatimit dhe specifikimeve teknike;
- Dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjetet mbrojtëse përkatëse;
- Mungon pasqyra e realizimit të punimeve sipas formatit tip;
- Mungon dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjetet mbrojtëse përkatëse;
- Plan-organizimi i punimeve të ndërtimit;
- Libri i kantierit;

-Aktet e inspektimeve të kryera gjatë zbatimit të punimeve;

-Akti i kolaudimit

Nga mbikëqyrësi i punimeve, Ing. Kelvin Skrela është vepruar në kundërshtim me:

-ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7,

- udhëzimin e KM nr.3, datë 15.02.2001 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të KM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 3.2 dhe 3.3

- me kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetin Kontraktor ish-Komuna Kaçinar, Mirditë ku përcaktohen Detyrimet e mbikëqyrësit (*Më hollësisht trajtuar faqet nr. 28-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

D. MASA DISIPLINORE:

Në shkallë Bashkie kemi rekomanduar gjithsej **26 masa disiplinore**, nga të cilat:

-për 11 punonjës në nivel përgjegjës sektori dhe juristë, të cilët kanë kryer shkelje në procedurat e prokurimit publik me masën “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “Pezullim nga e drejta për ngritjen në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”.

-për 4 punonjës në nivel N/kryetar bashkisë, përgjegjës sektori dhe specialistë “Zgjidhjen e Kontratës së Punës”.

-për 11 punonjës me kod pune në nivel specialistë “Vërejtje”.

D.1. Për nëpunësit të cilët janë pjesë e shërbimit civil

Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “b”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 germa g dhe k të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë që ti kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për 11 punonjës, si më poshtë:

I. “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “Pezullim nga e drejta për ngritjen në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, parashikuar në nenin 58 shkronja (b) dhe (c), për 11 punonjës, si më poshtë:

1. V.T, inspektor i taksave vendore, në cilësinë e anëtarit të njësisë prokurimit dhe të KVO, për shkeljet e mëposhtme:

-për shkelje procedurave në objektin “Rikonstruksion i 15 shtëpive të Komunitetit Romëve dhe Egjiptianeve, Bashkia Mirditë”, pasi padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik “XXXXXXXXXX” shpk, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-për 1 rast me mangësi ligjore në procedurën e prokurimit publik,” Furnizim me mish për institucionet shkollore e parashkollore për vitin 2016 Bashkia Rrëshen” në vitin 2015, për mos anulimin e procedure dhe shpalljen fitues të operatorit ekonomik person

fizik, në kundërshtim me nenin 24 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar “Për prokurimin publik”.

-për mos vjeljen e takses hapsirës publike (tregu) sipas kontratave përkatëse për vlerën 1,472 mijë lekë mungesë të ardhurash. Për planifikim me rezerva të taksës pastrimit familjar për vitin 2015 për vlerën 1,220 mijë lekë. Për mos vjeljen e debitorëve të taksave vendore deri më datë 01.12.2015, për 831 mijë lekë për 22 subjekte fizike.

2. V.P, inspektor i aseteve publike, në cilësinë e antarit të njësisë prokurimit dhe të KVO, për shkeljet e mëposhtme:

-për shkelje procedurave në objektin “Rikonstruksion i 15 shtëpive të Komunitetit Romëve dhe Egjiptianeve, Bashkia Mirditë”, pasi padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik “” shpk, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-për shkelje si antar i njësisë prokurimit në vendosjen e disa kriterëve jo të qarta dhe dytësore për kualifikim, të cilat kanë ndikuar në eliminimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt “Riveshja e rrugës Shën Vincenzo De Paoli & rruga At Gjergj Fishta” Bashkia Rrëshen, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 15, 26/5, 28/2/5/c e ç, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar neni 45, trajtuar më konkretisht në raportin e auditimit.

3. F.LI, specialist urbanistikës Mirditë, në cilësinë e antarit të njësisë prokurimit, për shkeljet e mëposhtme:

-për shkelje në vendosjen e disa kriterëve jo të qarta dhe dytësore për kualifikim, të cilat kanë ndikuar në eliminimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt “Riveshja e rrugës Shën Vincenzo De Paoli & rruga At Gjergj Fishta” Bashkia Rrëshen, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 15, 26/5, 28/2/5/c e ç, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar neni 45, trajtuar më konkretisht në raportin e auditimit.

-për 1 rast me shkelje ligjore në procedurën e prokurimit viti 2014, me efekte financiare për vlerën 336,138 lekë dëm ekonomik, në objektin “Rikonstruksion i rrugës Ura e pazarit-Varrezat publike, Unaza e madhe Bashkia Rrëshen” dhe për mos argumentimin e fondit rezervë 5%, me proceverbal të detajimit të përdorimit të fondit rezervë dhe miratimin e tij.

4. A.M, ing. Ndërtimi, përgjegjes i Urbanistikës, antar i Njësisë së Prokurimit ish-Bashkia Rrëshen dhe,

5. V.B, juriste, antare e Njësisë së Prokurimit ish-Bashkia Rrëshen, për shkeljet e mëposhtme të përbashkëta:

-për 1 rast me shkelje ligjore me efekte financiare për vlerën 336,138 lekë dëm ekonomik, në objektin “Rikonstruksion i rrugës Ura e pazarit-Varrezat publike, Unaza e madhe Bashkia Rrëshen, viti 2014”, nga preventivimi i gabuar i zërit punimeve “gërmime shtrese rrugore dhe transport me makineri”, duke rritur artificialisht fondin limit, në kundërshtim me manualin teknik të çmimeve miratuar me VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike, të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

-për vendosjen e kushteve të paargumentuara duke kufizuar pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomikë dhe për mos argumentimin e fondit rezervë 5%, me proceverbal të detajimit të përdorimit të fondit rezervë dhe miratimin e tij.

6. Gj.R., inspektor i taksave vendore në cilësinë e antarit të KVO, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos realizim të ardhurash vendore për vitin 2014 për diferencën 27,839 mijë lekë, dhe për vitin 2015 për diferencën 16,675 mijë lekë.

-për mos vjeljen e takses hapsirës publike (tregu) sipas kontratave përkatëse për vlerën 1,472 mijë lekë mungesë të ardhurash për vitin 2014 dhe 2015.

-Për planifikim me rezerva të taksës pastrimit familjar për vitin 2015 për vlerën 1,220 mijë lekë dhe mos vjeljen e debitorëve të taksave vendore deri më datë 01.12.2015, për vlerën 831 mijë lekë për 22 subjekte fizike si dhe mos aplikim sanksionesh për subjektet e parregullta në shlyerjen e detyrimeve tatimore, në kundërshtim me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për taksat vendore” .

-për 1 rast me mangësi ligjore në procedurën e prokurimit publik,” Furnizim me mish për institucionet shkollore e parashkollore për vitin 2016 Bashkia Rrëshen” në vitin 2015, për mos anulimin e procedurës së prokurimit dhe shpalljen fitues të operatorit ekonomik, personi fizik, në kundërshtim me nenin 24 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar “Për prokurimin publik”, pasi operatori i shpallur fitues nuk plotëson 2 kërkesat e DST, në kundërshtim me nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar “Për prokurimin publik”.

7. V.Gj., financiere, me detyrë përgjegjëse e zyrës së Financës ish-Bashkia Rrëshen, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos zbatimin e rekomandimeve të lëna më parë nga KLSH sipas shkresës nr. 1188/72, datë 27.3.2015 dhe shkresës nr.150/9, datë 30.6.2012, për vlerën 11,394,513 lekë dëm ekonomik, ku ka patur mundësi zbatimi, pasi disa punonjës janë në marrëdhënie pune me bashkinë Mirditë.

-për 2 raste shkelje ligjore në procedurat e blerjeve me vlera të vogla, në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 11.06.2014” Për disa shtesa në VKM nr. 1, datë 10.1.2007,”Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe për kryerjen e pagesës në vlerën 172,000 lekë dëm ekonomik.

-për mos hartimin e programit të regjistrimit të vlerave të pronave në kontabilitet për pasuritë e llojit pyll dhe kullotë, pronë e ish-Bashkisë Rrëshen në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit 30 datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”kap.IV “Sistemi periodik i aktiveve”, të Ministrit të Financave dhe pikës 22 të VKM nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

-për mos marrjen e masave trajnuese për njohjen e ligjit për MFK, si dhe vënien në zbatim të tij, në administratën e Bashkisë Rrëshen, në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

8. A.T., me detyrë përgjegjëse e Financës ish-Bashkia Rubik, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos hartimin e programit të regjistrimit të vlerave të pronave në kontabilitet për pasuritë e llojit pyll dhe kullotë, të ish-Bashkisë Rubik në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe pikës 22 të VKM nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”

-për shpërblimin e 15 këshilltarëve të bashkisë, për punë të mirë dhe mbledhje jashtë radhe gjatë vitit me nga 1 pagë mujore nga fondi rezervë sipas urdhër shpenzimit nr. 278, datë 30.12.2014 për vlerën 107,325 lekë dëm ekonomik, ku ne fakt është e kundërta pasi ka mos pjesëmarrje ne mbledhjet e radhës, në kundërshtim me VKM nr. 472, datë 02.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

9. Gj.P., në cilësinë e antarit të KVO, ish-komuna Orosh dhe

10. A.S., në cilësinë e antarit të KVO, ish-komuna Orosh

Për shkeljet e përbashkëta:

-për shkelje 1,7 milion lekë mos efektivitet të fondeve publike, në 1 tender ”Furnizim me pajisje dhe mjete për shërbimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane Komuna Orosh për vitin 2014”, pasi kanë kualifikuar shpk “██████” me çmim më të lartë nga çmimet e tregut dhe dokumenteve të origjinës (doganore) për blerjen e 1 Makinë teknologjike, për nevoja të pastrimit qytetit Reps.Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

11. P.Ll., në cilësinë e antarit Njesisë së Prokurimit të autoritetit kontraktor Bashkia Mirditë, për shkeljet e mëposhtme:

-për 1 rast me mangësi ligjore në procedurën e prokurimit,” Furnizim me mish për institucionet shkollore e parashkollore për vitin 2016 Bashkia Rrëshen” në vitin 2015,
-për mos administrim të dokumentacionit të tenderit konkretisht ”në dosje disponohet kontrata e vjetër nr. 192 date 15.01.2015, në vend të kontratës re”në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014”Për rregullat e prokurimit publik”, neni 57 ”Njësia e prokurimit”, pika 2.

D.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neneve 11 dhe 12, të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Mirditë**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave të mëposhtme:

I. “Zgjidhjen e Kontratës së Punës”, për 4 punonjës, si më poshtë:

1. M.P, Inxhinier, N/Kryetar i Bashkisë Mirditë, në cilësinë e kolaudatorit punimeve, antarit të KVO dhe të njesisë prokurimit, për shkeljet e mëposhtme:

- për shkelje në 1 rast në cilësinë e kolaudatorit të punimeve në objektin “Ndërtim Ujësjiellësi për Fshatrat Arrëz, Kaçinar, Simon”, Ish-Komuna Kaçinar, Mirditë, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 7,233,509 lekë për punime të pakryera.

-për 1 rast me mangësi ligjore në procedurën e prokurimit viti 2014, me efekte financiare për vlerën 1,406,247 lekë dëm ekonomik, në procedurat e prokurimit me objekt “Ndërtim sistem ngrohje shkolla 9 vjecare në qytetin Rubik viti 2014”, nga KVO është vepruar me dy standarte në vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit,

pasi të dy operatorët kanë pasur mangësi në plotësimin e kriterëve të vendosura në DST, por është përzgjedhur operatorit [REDACTED] International me ofertë më të lartë dhe duke skualifikuar operatorin me ofertën më të ulët, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

-për 1 rastë shkelje të dispozitave ligjore, për mos anulimin e procedurës së prokurimit publik “Blerje ushqime për kopshtin, cerdhen dhe konviktin e shkollës së mesme në ish-Bashkinë Rubik” viti 2015 pasi dy ofertuesit kishin mangësi në plotësimin e kushteve të përcaktuara në DST, në kundërshtim me nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014.

-Për shkelje si antar i njësisë prokurimit në vendosjen e disa kriterëve jo të qarta dhe dytësore për kualifikim, në objektin “Riveshja e rrugës Shën Vincenzo De Paoli & rruga At Gjergj Fishta” Bashkia Rrëshen, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 15, 26/5, 28/2/5/c e ç, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar neni 45, trajtuar më konkretisht në raportin e auditimit.

-për shkelje në tenderin “Furnizim me pajisje dhe mjete për shërbimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane Komuna Orosh për vitin 2014”, për blerjen e 1 Makinë teknologjike pranë “[REDACTED]” shpk, me një vlerë të lartë, duke krijuar diferencën 1,7 milion lekë mos efektivitet të fondeve publike.

2. Gj.K, përgjegjësi i financës të Njesisë Administrative Fan, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos përputhje të vendit të punës si përgjegjës finance me profesionin e agronomit, pasi duhet arsimi i lartë ekonomik.

-për mos kontabilizimin dhe mos zbatimin e rekomandimeve të lëna më parë nga KLSH, për vlerën 352,424 lekë dëm ekonomik.

-për pagesën e dietave të tepërta dhe me mangësi dokumentare, për periudhën nëntor 2014 deri në korrik 2015 për vlerën 575,000 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit” .

-për aplikimin gabim të qirasë, për sipërfaqen 8974 m2 nga fondi pyjor kullosor i ish-Komunës Fan, për shumën 510,980 lekë dëm ekonomik.

3. Sh.P, inspektor i IMKTV bashkia Mirditë, paraqet mos përputhje të vendit të punës me profesionin ka mbaruar mësues, në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” i ndryshuar, neni 11.

4. N.M, inspektor i financës të Njesisë Administrative Fan, është me arsim të mesëm agronomi, ku duhej me arsimim të mesëm ekonomik.

III. “Vërejtje”, për 11 punonjës, sa vijon:

1. J.P, N/Kryetar i Bashkisë Mirditë, në cilësinë e antarit të njësisë prokurimit dhe të KVO , për shkeljet e mëposhtme:

-për shkelje procedurave në objektin “Rikonstrukcion i 15 shtëpive të Komunitetit Romëve dhe Egjiptianeve, Bashkia Mirditë”, pasi padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik “[REDACTED]” shpk, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-për shkelje në tenderin "Furnizim me pajisje dhe mjete për shërbimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane Komuna Orosh për vitin 2014", për blerjen e 1 Makinë teknologjike pranë shpk "██████", me një vlerë të lartë, duke krijuar diferencën 1,7 milion lekë mos efektivitet të fondeve publike.

-për kualifikimin dhe shpalljen fitues të padrejtë të një personi fizik në prokurimin me vlera të vogla "Furnizim me materiale elektrike, materiale ndërtimi, hidraulike etj, Bashkia Rrëshen", duke krijuar vlerën 172,000 lekë dëm ekonomik.

-për mos apelimin e vendimit Gjykatës shkallës parë Shkodër nr. 954, datë 09.12.2015 për subjektin juridik "██████" shpk, çka ka ndikuar negativisht në buxhetin e bashkisë për vlerën 3,163,258 lekë.

2. Gj.V, Administrator i Qytetit Rrëshen, në cilësinë e ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Rubik, për shkeljet e mëposhtme:

-për mosanullimin e 2 procedurave të prokurimit të zhvilluara nga autoriteti kontraktor ish-Bashkia Rubik konkretisht: në tenderin me objekt "Ndërtim sistem ngrohje shkolla 9 vjecare në qytetin Rubik viti 2014" me efekt financiar në vlerën 1,406,247 lekë dëm ekonomik dhe tenderin "Blerje ushqime për kopshtin, cerdhen dhe konviktin e shkollës së mesme në ish-Bashkinë Rubik" viti 2015, me mangësi në plotësimin e kushteve të përcaktuara në DST, në kundërshtim me kërkesat e nenit 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar "Për prokurimin publik" dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014.

-për mos zbatimin e procedurave të ndarjes së tokave të lira, pronë e ish-Bashkisë Rubik, në sipërfaqen 303 hektarë, mosngritjen e Komisionit të Qiradhënies së Tokës Bujqësore të Pandarë.

-për mos përgatitjen e dokumentacionit për regjistrimin e sipërfaqes 6755 hektarë pyje dhe kullota dhe për mos hartimin e programit të regjistrimit të vlerave të pronave në kontabilitet për pasuritë e llojit pyll dhe kullotë, të ish-Bashkisë Rubik.

-për mos ngritjen e strukturës së administrimit të aseteve, inventarizimin, gjendjes faktike dhe mbledhjen e të ardhurave nga kontratat e qirave të aseteve në administrim të Bashkisë Rubik.

3. T.P, përgjegjës i Zyrës Taksave Vendore, ish-Bashkia Rrëshen, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos realizim të ardhurash vendore për vitin 2014 për diferencën 27,839 mijë lekë, dhe për vitin 2015 për diferencën 16,675 mijë lekë.

-për mos vjeljen e takses hapsirës publike (tregu) sipas kontratave përkatëse për vlerën 1,472 mijë lekë mungesë të ardhurash për vitin 2014 dhe 2015.

-Për planifikim me rezerva të taksës pastrimit familjar për vlerën 1,220 mijë lekë,

-për mos vjeljen e debitorëve të taksave vendore deri më datë 01.12.2015, për vlerën 831 mijë lekë për 22 subjekte fizike, për mos aplikim sanksionesh për subjektet e parregullta në shlyerjen e detyrimeve tatimore, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 "Për taksat vendore", UMF dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar.

-për mangësitë e evidentuara në arkëtimin e vlerës 323,800 lekë dëm ekonomik detyrim kontraktor për fondin pyjor të dhënë me qira për vitin 2015, pronë e ish-Bashkisë Rrëshen në ekonominë pyjore Ulëz, parcela 25, sipërfaqja 500 m².

4. K.M, Administrator i Njësisë Administrative Fan, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos përgatitjen e dokumentacionit për regjistrimin e sipërfaqes prej 5622 hektarë pyje dhe kullota , pronë e ish-Komunës Fan,

-për mos hartimin e programit të regjistrimit të vlerave të pronave në kontabilitet për pasuritë e llojit pyll dhe kullotë, të ish-Komunës Fan,

-për aplikimin gabim të qirasë, për sipërfaqen 8974 m² nga fondi pyjor kullosor i ish-Komunës Fan, për shumën 510,980 lekë dëm ekonomik , nga vendosja e tubacionit për furnizimin me ujë të Hidrocentraleve "Shëngjon 1,2,3", në kundërshtim me VKM nr. 1064 datë 22.12.2010 'Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" Lidhja nr. 2 .

5. N.L, inspektor i Pyjeve dhe Kullotave ish-Bashkia Rubik, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos përgatitjen e dokumentacionit për regjistrimin e sipërfaqes 6755 hektarë pyje dhe kullota, pronë e ish-Bashkisë Rubik.

-për mos hartimin e planit të Menaxhimit të Pyjeve e Kullotave të ish-Bashkisë Rubik, miratuar me vendim të Këshillit Bashkisë Rubik, në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9585, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar.

6. J.P, inspektor i taksave vendore Bashkia Mirditë,

7. Gj.K, inspektor i taksave vendore bashkia Mirditë,

Për shkeljet e përbashkëta:

-Për mos realizim të ardhurash vendore për vitin 2014 për 27,839 mijë lekë dhe për vitin 2015 për diferencën 16,675 mijë lekë,

-për mos vjeljen e taksës hapsirës publike (tregu) për vlerën 1,472 mijë lekë mungesë të ardhurash përkatësisht: 372 mijë lekë për vitin 2014 dhe 1,100 mijë lekë për vitin 2015, diferencë kontraktore e taksës së tregut,

-Për planifikim me rezerva të taksës pastrimit familjar për vitin 2015 për vlerën 1,220 mijë lekë, pasi është planifikuar 500 mijë lekë nga 1,720 mijë lekë që duhej .

-për mos vjeljen e debitorëve të taksave vendore deri më datë 01.12.2015, për vlerën 831 mijë lekë për 22 subjekte fizike, dhe për mos aplikim sanksionesh për subjektet e parregullta në shlyerjen e detyrimeve tatimore, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 "Për taksat vendore", UMF dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar.

8. S.Gj, Inspektor i Pyjeve dhe Kullotave Bashkia Mirditë, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos përgatitjen e dokumentacionit për regjistrimin e sipërfaqes 5549 hektarë pyje dhe kullota, prona të bashkisë.

-për mos hartimin e planit të Menaxhimit të Pyjeve e Kullotave të ish-Bashkisë Rubik, miratuar me vendim të Këshillit Bashkisë Rubik, në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9585, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar.

-për mos mbajtje të evidencave mbi dëmtimin apo shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, pronë e ish-Bashkisë Rrëshen, në kundërshtim me ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", neni 37.

9. P.P, inspektore e tatim taksave të ish-Komunës Orosh, për shkeljet e mëposhtme:

-për mosndjekjen e dhënies me qira të objekteve pronë e ish-Komunës Orosh, të kontratave të lidhura me 10 persona, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin e ish-Komunës Orosh në shumën 272,400 lekë, në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Komunës Orosh nr. 1, datë 21.1.2014 si dhe nenit 35 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore".

-për mos ndjekje të kontratave të lidhura me subjektin [REDAKTUAR], stacioni Nënshajt, për shumën 226,800 lekë për vitin 2015, mungesë të ardhurash në buxhetin e ish-Komunës Orosh në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe VKM nr. 1064 datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" Lidhja nr. 2.

10. Ndrec Mjeshtri, inspektor i taksave Njësia Administrative Orosh, ish-përgjegjës i shërbimeve dhe antar i njësisë prokurimit, për shkeljet e mëposhtme:

- për mos përfundimin e procesit të dhënies së AMTP (akteve të marrjes së tokës në pronësi) për mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me VKM nr. 253, datë 6.3.2013 "Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish -kooperativave bujqësore", pika 2 dhe nenit 17 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë së krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", i ndryshuar.

-për mosndjekjen e dhënies me qira të objekteve pronë e ish-Komunës Orosh, të kontratave të lidhura me 10 persona, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin e ish-Komunës Orosh në shumën 272,400 lekë, në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Komunës Orosh nr. 1, datë 21.1.2014 si dhe nenit 35 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore".

-për shkelje në tenderin "Furnizim me pajisje dhe mjete për shërbimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane Komuna Orosh për vitin 2014", për blerjen e 1 Makinë teknologjike pranë shpk "[REDAKTUAR]", me një vlerë të lartë, duke krijuar diferencën 1,7 milion lekë mos efektivitet të fondeve publike.

11. Gj.N, inspektor i zyrës tatim taksave të Njësies Administrative Fan, është me arsim të mesëm agronomi, ku duhej me arsimim të mesëm ekonomik.

D.3. NJOFTIM DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Njësia e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17 të ligjit nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11- Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës”, të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Lezhë për:

K.S. (në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës “**[REDACTED]**” Shpk (firma mbikëqyrëse me të cilin është lidhur kontrata për mbikëqyrjen e punimeve), pasi ka kryer veprime të kundërligjshme duke raportuar dhe likuiduar punime të pakryera në shumën **12,308,391 lekë**, në objektet “Ndërtim Ujësjiellësi për Fshatrat Arrëz, Kaçinar, Simon”, ish Komuna Kaçinar, Mirditë, raportuar punime të pakryera në vlerën 7,233,509 lekë pa tvsh dhe “Rikonstruksion Shkolla 9-vjeçare Kaçinar”, ish Komuna Kaçinar, Mirditë, raportuar punime të pakryera në vlerën 5,074,882 lekë pa tvsh, të cilat referuar përmbajtjes së dispozitës penale, neni 248 dhe neni 258 i Kodit Penal, mbartin elementët e veprës penale të “*Shpërdorimit të detyrës*” dhe janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, pikat 3.2 dhe 3.3 të Udhëzimit të KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik i Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R